

Planprogrami mësimor i lëndës – syllabusi: Menaxhimi i dijës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i dijës
Niveli:	Bachelor (BSc)
Statusi lëndës:	Tgjedhore
Viti i studimeve:	Viti III, Semestri 5
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	UKZ
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<p>Dituria konsiderohet si asset shume i rendesishem dhe paraqet faktorin kritik per nje organizate. Ne nje konkurrence nderkombetare, ku kjo konkurrence eshte e perhapur ne menyre globale, roli i diturise si aset strategjik po behet gjithnje e me i theksuar. Globalizimi dhe dinamika e rrethines se biznesit domosdoshmerisht ndermarrjet duhet ta kapitalizojne diversitetin e tyre edhe pertej kufive nese deshirojne ta rrisin profitabilitetin.</p> <p>Për dallim nga kapitali dhe mjetet, dituria e koncentruar ne fuqinë punëtore shërben jo vetëm në organizatë, por edhe për të mirën e shoqërisë në nivel të gjerë nga të mirat që i prodhon dhe u ofron kesaj shoqërie. Në atë moment kur është zbuluar diçka e re, eshte zbuluar nje dituri e re. Shfrytezimi dhe shperndarja e saj pasi te jet bërë publike është shumë e lehtë dhe nuk e ka koston qe e ka pasur deri sa eshte arritur dituria, por pas zbulimit, dituria ka nje kosto shumë më të ulët se investimi qe eshte bere deri sa eshte përvetësuar ajo dituri.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllim i kesaj lende eshte qe te aftesoje studentin me dituri te mjaftueshme qe te menaxhoje proceste e zhvillimit te BNJ ne organizate, te rinovoje diturine e tyre dhe te shperndaje kete dituri brenda subjektit te vete ekonomik dhe me gjere, te beje transferin e diturise brenda dhe jashte organizates, te studjoje dhe te perfitoje shkathtesi te mjaftueshme per te njohur dhe zhvilluar keto proceste ne organizate.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Studentët pas përfundimit të këtij moduli do të fitojnë njohuri se si bizneset moderne përballen me sfidën e ekonomisë së bazuar në njohuri. Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë kompetentë të përdorin mjete dhe teknika të menaxhimit të njohurive, të zhvillojnë aplikacione për menaxhimin e njohurive, të dizenojnë dhe</p>

	<p>zhvillojnë aplikacione ndërmarrjeje. Mes tjerash studentet duhet te:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të dish çka (know-what), ose dituria mbi faktet, që dita ditës po bëhet më e parëndësishme, - Të dish pse (know-why), është dituria mbi natyrën e globit, shoqërinë dhe mendjen njerëzore, - Të dish kush (know-who), Të njohësh njerëzit e duhur nganjëherë është më e rëndësishme për inovacionet sesa të kesh dituri mbi principet shkencore, - Të dish ku (know-where) dhe të dish kur (know-when) çdo herë e më shumë po bëhen më të rëndësishme në ekonominë fleksibile dhe dinamike. - Të dish si (know-how), i referohet shkathtësive, aftësisë për të bërë gjërat në praktikë.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15 javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15 javë	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15 javë	15
Kollokfiume,seminare	3	3 ditë	9
Detyra të shtëpisë	1	3 ditë	3
Punë praktike	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15 javë	45
Përgaditja përfundimtare për provim	3	3 ditë	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4	4 ditë	16
Projektet,prezentimet ,etj	2	4 ditë	8
Totali			150 orë

Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 6 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë

Metodologjia e mësimdhënies:

Përfundimi i modulit dhe respektimi i kërkesave të tij do t'i mundësojnë studentëve të përvetësojnë kuptimin e koncepteve kryesore të lëndës të trajtuara në ligjërata dhe ushtrime si dhe aftësimin e tyre me kompetencat përgjegjëse.

Metodat e vlerësimit:

Moduli vlerëson punën dhe përgatitjen e studentit. Vlerësimi duhet të përfshijë pjesëmarrje aktive dhe angazhim të studentit në një numër elementësh të procesit mësimor të treguar në tabelën

- Vijimi i ligjeratave dhe aktiviteti	10%	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	
- Testi/kollokviumi I	45%		91-100	10 (dhjetë)
- Testi /kollokviumi II	45%	81-90	9 (nëntë)	B
Totali:.....	100%	71-80	8 (tetë)	C
Vërejtje:		61-70	7 (shtatë)	D
Studentët kanë mundësinë të finalizojnë notën e tyre përmes K1 dhe K2.		51-60	6 (gjashtë)	E
Nëse studentët nuk janë të kënaqur me notën finale, atëherë ata mund ti nënshtrohen provimit final i cili		35-50	5 (pesë)	F
		0-34	5 (pesë)	FX

Literatura	
Literatura bazë:	-Jashopara A (2011): Knowledge Management: An integrated approach, 2ed, Prentice Hall ISBN 978-0-273-72685-2. -Davenport T., Prusak L.: Working Knowledge: How organizations manage what they know, Harvard Business School Press, 2010. -Authorized lectures
Literatura shtesë:	-Hall, Richard (2009): Knowledge Management in the New Business Environment, acirtt, University of Sydney, 2003. -Hull D & Read R (2008): Simply the best workplaces in Australia, accirt working paper no 88, University of Sydney.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Zhvillimi historik i menaxhimit të diturisë
Java e dytë:	Dituria dhe zhvillimi i prodhimit
Java e tretë:	Modeli i rritjes së dijes, shkaqet e ekspansionit të dijeve
Java e katërt:	Kuptimi i menaxhimit të dijes
Java e pestë:	Dimensionet e menaxhimit të dijes
Java e gjashtë:	Menaxhimi i rrjedhjes së dijes mjetet për menaxhimin e diturisë
Java e shtatë:	Testi I
Java e tetë:	Ndertimi i kornizës së menaxhimit të dijes në organizatë
Java e nëntë:	Kapitali intelektual
Java e dhjetë:	Ekonomia e dijes
Java e njëmbëdhjetë:	Ndermarrjet që mesojnë
Java e dymbëdhjetë:	Dituria si shtyllë qendrore për zhvillimin ekonomik
Java e trembëdhjetë:	Transferi i diturisë
Java e katërbëdhjetë:	Transferi brendshëm dhe ai i jashtëm i diturisë
Java e pesëmbëdhjetë:	Provim final
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijimi i rregullt i ligjëratarave dhe ushtrimeve është i obliguar për të gjithë studentët e rregullt. Të gjithë studentët janë të obliguar që t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë, çkyçja e telefonave celularë dhe hyrja në sallë me kohë.	